


# Kontratat emergjente dhe ulja e konkurrencës në prokurim publik përgjatë pandemisë

Qershor, 2021





Ky publikim është botuar me mbështetje financiare të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur.  
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë  
nuk mund të paraqes pikëpamjet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur.

## STAFI EDITORIAL

Agon Hysaj (Autor)

Arbelina Dedushaj (Kontribuese)

Egzona Kozhani (Kontribuese)



Vizitoni faqen tone në internet  
[www.dplus.org](http://www.dplus.org)

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit, lajmeve dhe infografikave online.



Find us on Facebook  
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Find us on Twitter  
[@democracyplus](https://twitter.com/democracyplus)



Find us on YouTube  
[@democracyplus](https://www.youtube.com/democracyplus)

### Zyrja jonë:

Rruga Tirana, Blloku C/4/1, Hyrja C, Kati VIII,  
Nr. 83/84 Prishtinë, 10000  
Kosovo

+383 (0) 38 749 288  
[info@dplus-ks.org](mailto:info@dplus-ks.org)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet, ose transmetohet në çfarëdo forme ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, ose tjera, pa lejen e D+. Falënderojmë Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) për përkrahjen financiare të kësaj iniciative. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.



**KONTRATAT  
EMERGJENTE DHE  
ULJA E  
KONKURRENCËS NË  
PROKURIM PUBLIK  
PËRGJATË PANDEMISË**

# Përmbajtja

Shkurtesat	7
Hyrje	8
Përmbledhje	9
Kontratat emergjente gjatë periudhës mars 2020 - mars 2021	10
Ministria e Shëndetësisë - Furnizim Emergjent me pajisje dhe material shpenzues medicinal për Corona-Virus	13
QKUK - Furnizim emergjent me material medicinal për COVID-19 jashtë LE për ShSKUK	14
Komuna e Gjakovës - Marrje në shfrytëzim të pajisjeve me sensorë për dezinfektimin e duarve me dezinfektant	16
Komuna e Shtimes - Furnizim emergjent me material mbrojtës për COVID-19	17
Komuna e Podujevës – Furnizim me mjete higjienike parandaluese dhe mbrojtëse kundër COVID-19 për nevoja të shkollave	18
Policia e Kosovës - Furnizim me material mbrojtës maska dhe dezinfektues	19
Komuna e Prizrenit - Furnizim me tableta për shkollat e Komunës së Prizrenit	21
Komuna e Skënderajt - Furnizim me projektor për shkolla dhe tabletë për nxënës	23
Rekomandime:	25

# Shkurtesat

AK	Autoriteti Kontraktues
ISO	Organizata Internacionale për Standardizim
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
LPP	Ligji i Prokurimi Publik
LPP	Ligji për Prokurim Publik
OE	Operatori Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PK	Policia e Kosovës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik



# Hyrje

Me fillimin e pandemisë në mars të vitit 2020, prokurimi publik filloi të përballej me sfida të reja me të cilat nuk ishte përballur më herët. Së bashku me pandeminë erdhi edhe emergjenca për t'u furnizuar me produkte mbrojtëse, të cilat do t'i mbronin qytetarët që mos të prekeshin nga koronavirusi.

Për shkak të kësaj emergjence ekstreme dhe masave të marra nga Qeveria e Kosovës, autoritetet kontraktuese kanë përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për të lidhur kontrata. Në këtë valë pandemie, ku të gjithë sektorët kanë qenë të prekur, vlen të theksohen shëndetësia dhe arsimiti. Shëndetësia për faktin e rolit që ka luajtur duke qenë në front në përballje me pandeminë dhe arsimiti, si një sektor i ndjeshëm që prek edukimin e gjeneratave të ardhshme. Përgjatë një viti të pandemisë shkollat në shumicën e kohës kanë qenë të mbyllura, ndërsa mësimi online ka qenë për shumë nxënës i paqasshëm për shkak të mungesës së pajisjeve. Për shkak të mbylljes, është bërë e detyrueshme ndjekja e mësimi online, gjë që ka bërë që autoritetet kontraktuese të fillojnë me blerjen e produkteve mbrojtëse, dezinfektimin e ambienteve dhe blerjen e pajisjeve që do ta lehtësonin mësimdhënies nga distanca.

Konkurrenca dhe ekonomiciteti janë disa nga parimet kryesore në prokurim publik. Megjithatë përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë e ul konkurrencën dhe bën që kontratat në përgjithësi të lidhen me çmime më të larta se ato të tregut. Në këtë raport fokus kanë qenë kontratat emergjente, mirëpo ka edhe tenderë që janë zhvilluar përmes procedurës së hapur me qëllim të krahasimit të çmimeve.

Demokrasi Plus (D+) ka analizuar të gjitha kontratat e lidhura nga marsi 2020 deri në mars 2021 që kanë të bëjnë me luftimin e pandemisë në fushën e shëndetësisë dhe të arsimit. D+ ka analizuar çmimet e kontratave, numrin e ofertuesve të ftuar, specifikat teknike dhe zhvillimin e negociatave. Kjo kohë ishte shfrytëzuar për t'u lidhur kontrata me kompani që asnjëherë nuk kishin fituar kontratë publike, gjë që ka ngritur dyshime për keqpërdorime, në një situatë ku të gjithë e kanë pasur vëmendjen vetëm te shpëtimi i jetës së njerëzve.

Vlen të ceket që disa autoritete kontraktuese kanë vazhduar të lidhin kontrata me negocim edhe pas gati një viti që po përballemi me pandeminë. Përdorimi i kësaj procedure më nuk është i nevojshëm, meqë autoritetet kontraktuese kanë kohën e mjaftueshme që të bëjnë planifikimin për çdo furnizim, shërbim apo punë.

Përveç kësaj, autoritetet kontraktuese kanë shmangur përdorimin e negociatave gjatë lidhjes së këtyre kontratave emergjente. Negociata që shihen si mundësi e autoriteteve kontraktuese për t'i ulur çmimet e operatorëve ekonomikë, nuk janë shfrytëzuar sa duhet, me ç'rast është dëmtuar buxheti i shtetit.



# Përmbledhje

Për qëllim të këtij raporti janë monitoruar nëntë tender, ku disa janë zhvilluar me procedurë emergjente e disa me procedurë të hapur.

Përdorimi i procedurës së negociuar (emergjente) si fillim ka qenë i arsyeshëm dhe i nevojshëm për t'u dalë në ndihmë nevojave të qytetarëve dhe për të ndihmuar në luftën kundër pandemisë. Mirëpo, vazhdimi i përdorimi të kësaj procedurë edhe pas një viti të pandemisë është i panevojshëm, meqë çdo autoritet kontraktues ka kohën e mjaftueshme për të studiuar fillimisht nevojat dhe pastaj të iniciojë procedurën e hapur sipas LPP-së. Me fjalë të tjera, situatat tani janë të qarta, nevojat janë të qarta, prandaj përdorimi i procedurës së tillë edhe pas kësaj kohë, mund të çojë vetëm në përshtatje dhe montim të tenderëve për kompani të caktuara.

Si rezultat i procedurës së negociuar ka pasur numër të vogël ofertuesish, që ka bërë që çmimet të jenë shumë më të larta, krahasuar me tenderët e zhvilluar me procedurë të hapur. Rast konkret është në komunë e Shtimes dhe të Podujevës, të cilat kanë përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, për të lidhur kontratë për furnizim me maska dhe dezinfektues. Çmimet në këto dy kontrata janë më të larta me kontratat tjera që janë lidhur në të njëjtë periudhë, por përmes procedurë të hapur.

Përveç kësaj, këto dy komuna kishin zhvilluar fare negociata. Pavarësisht që kjo është në diskrecion të autoriteteve kontraktuese që të negociojë për kushtet e kontratës, kryesisht për ulje të çmimeve, mungesa e tyre dëshmon se autoritetet kontraktuese nuk janë përpjekur për të ulur çmimin.

Komuna e Gjakovës ka kërkuar certifikatë ISO të panevojshme për natyrën e kontratës në tenderin për marrje në shfrytëzim të pajisjeve për dezinfektim. Këtë kërkesë e ka bërë vetëm 7 ditë para afatit për dorëzim të ofertave, ku ua ka bërë të vështirë kompanive të tjera të ofertojnë.

Rast tjetër të keqplanifikimit të aktivitetit të prokurimit është tenderi i QKUK për furnizim emergjent me material medicinal. QKUK anuloi tenderin pasi konsideroi se oferta e OE ka çmim të lartë edhe pse i njëjti ka zbritur çmimin e ofertës për afro 16 mijë euro dhe ishte brenda vlerës së parashikuar së tenderit. Në njërin anë QKUK ka përdorur procedurën e negociuar për të lidhur kontratë me arsye gjendja emergjente e në anën tjetër ka tentuar ta anulojë tenderin. Këto dy veprime nuk janë në përputhje me njëra tjetrën, pasi nëse qëllimi i përdorimit të procedurës së negociuar është emergjenca, atëherë autoriteti kontraktues nuk duhet të bëjë veprime që pengojnë lidhjen e kontratës.

Komuna e Skënderajt dhe ajo e Prizrenit në tenderët për furnizim me tabletë për nxënës për mësim online kanë shpërblyer me kontratë kompani që nuk i kanë plotësuar specifikat teknike. Për më tepër Komuna e Prizrenit deri më 5 maj 2021 nuk i ka pranuar tabletët, në kohën kur gati viti shkollor është duke përfunduar, ndërsa kontrata është nënshkruar më 1 mars 2021.

# Kontratratat emergjente gjatë periudhës mars 2020 - mars 2021

Demokrasi Plus ka analizuar të gjitha kontratat e lidhura përmes procedurës së negociuar në fushën e shëndetësisë dhe arsimit të cilat për qëllim kanë pasur luftimin e pandemisë COVID-19.

Nga marsi i vitit 2020 deri në marsin e vitit 2021, janë nënshkruar 268 kontrata përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë (apo kontrata emergjente) me një vlerë mbi 18 milion euro. Në vetëm 28 prej tyre autoritetet kontraktuese kanë ftuar kompanitë për të negociuar dhe si rezultat janë ulur çmimet. Shuma që është ruajtur përmes negociimit vetëm në këto 28 kontrata kap vlerën prej 168,387.38 euro, shumë e cila me siguri do të ishte më e lartë sikur autoritetet kontraktuese t'i ftonin operatorët ekonomik për negociata. Mesatarisht çmimi është ulur për rreth 4%, nga totali prej 4.17 milion euro në 4 milion euro.

Është shqetësuese, që nga 268 kontratat që janë lidhur me procedurë emergjente, 27 prej kompanive fituese nuk janë të specializuara në fushën për të cilën janë kontraktuar. Në 18 nga 27 tyre është ftuar vetëm një kompani që të ofertojë. Kjo përveç tjerash është shkelje ligjore, pasi Ligji për Prokurimin Publik i obligon autoritetet kontraktuese t'i ftojë kompanitë e përshtatshme për të ofertuar.

Konkurrenca është zvogëluar ndjeshëm më përdorimin e kësaj procedurë. Mesatarisht në vitin 2019 për çdo tender janë pranuar nga pesë oferta<sup>1</sup>. Për këto 268 kontrata janë pranuar mesatarisht nga 1.6 oferta.

---

<sup>1</sup> Raporti mbi aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2019. KRPP. 2020. <https://dpl.us/f6r>

TABELA 1 — Numri i ofertave për 268 kontrata të periudhës mars 2020 – mars 2021

167 kontrata	Vetëm një ofertë
53 kontrata	Dy oferta
38 kontrata	Tri oferta
9 kontrata	Katër oferta
1 kontratë	Pesë oferta

Për 167 kontratë ka pasur vetëm një ofertues, ndërsa asnjë tender nuk ka pasur më shumë se pesë oferta. Një nga parimet bazë të prokurimit publik është konkurrenca dhe ajo ekziston gjatë tenderëve të kenë çmime më të ulëta.

Në anën tjetër, gjatë periudhës kohore shtator-dhjetor 2020 janë nënshkruar 76 kontrata përmes procedurës së hapur e ku numri mesatar i ofertave për një tender është 7.71.

Për qëllim të krahasimit të çmimeve D+ ka analizuar tri produktet më të zakonshme në luftën kundër pandemisë, siç janë: maskat e thjeshta, maskat me filtër FFP2 dhe dezinfektuesit. Janë krahasuar çmimet e kontratave që janë lidhur me procedurë të hapur dhe të atyre me procedurë të negociuar. Krahasimi është bërë për çdo muaj, nga korriku 2020 deri në mars 2021. Siç vërehet nga tabela më poshtë ka dallime të mëdha në çmime sa i përket kontratave të lidhura me procedurë të hapur dhe atyre të lidhura me procedurë emergjente. Gjatë periudhës kohore korrik-dhjetor 2020, për një maskë të thjeshtë, çmimi mesatar që është paguar përmes kontratës së hapur është 0.14 euro, ndërsa me procedurë të negociuar 0.29 euro, dallim ky prej 107%. Ndërkaq për një maskë pak më të avancuar, ajo me filtër FFP2, çmimi mesatar ka qenë 1.53 euro, ndërsa në procedurë të negociuar është blerë me 4.01 euro, ose 162% më shtrenjtë.

TABELA 2 — Krahasimi i çmimeve për muaj për kontrata në procedurë të hapur krahasuar më të negociuar

Muaji	Maskë thjeshtë	Maskë FFP2	Dezinfektues 1l	Dezinfektues 500ml
<b>Procedura e Hapur – Çmimi mesatar në euro</b>				
Korrik 2020	0.24	3.00	3.67	2.61
Gusht 2020	0.15	0.90	3.31	2.00
Shtator 2020	0.16	/	2.51	2.37
Tetor 2020	0.10	0.8	1.75	2.40
Nëntor 2020	0.14	1.58	2.80	2.03
Dhjetor 2020	0.06	/	3.00	1.74
Janar – Mars 2021	0.03	/	2.20	1.80
<b>Procedura e Negociuar – Çmimi mesatar në euro</b>				
Korrik 2020	0.44	6.13	/	5.00
Gusht 2020	0.55	/	4.6	2.95
Shtator 2020	0.19	2.93	10.25	3.10
Tetor 2020	/	/	/	2.00
Nëntor 2020	0.20	3.00	/	4.02
Dhjetor 2020	0.14	/	/	3.65
Janar – Mars 2021	0.09	/	/	/

Përveç këtyre dy lloj maskash, për të njëjtën periudhë janë analizuar edhe çmimet për dezinfektues 1 litërsh dhe 500 ml. Çmimi i kontratës së lidhur me procedurë të hapur për dezinfektuesin 1 litërsh ka qenë 2.94 euro, ndërsa në kontratën e negociuar 7.74 euro – dallimi prej 163 %. Ndërkaq, për dezinfektuesin 500 ml, autoritetet kontraktuese që kanë përdorur procedura të hapura e kanë blerë për 2.22 euro, ndërsa me ato me procedurë të negociuar i kanë blerë me 3.72 euro, apo 68% më shtrenjtë.

Çdo muaj për të katër produktet çmimet në e kontratave të lidhur përmes procedurës së hapur kanë qenë më të ulëta se të kontratave të lidhura me procedurë të negociuar.

Të gjitha të dhënat më lartë tregojnë se mungesa e konkurrencës shkakton çmime më të larta. Përderisa në fillimet e pandemisë, më të vërtetë gjendja ka qenë emergjente, kjo nuk mund të thuhet më gjashtë muaj pas fillimit të pandemisë. Prej gjysmës së dytë të vitit 2020 autoritetet kontraktuese kanë qenë në dijeni që pandemia tashmë është në mesin tonë dhe e kanë ditur që do të jetë edhe për një kohë prezente në bazë të parashikimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Prandaj nuk ka pasur asnjë arsye që në muajt në vazhdim të vazhdohet të lidhen kontrata përmes procedurës së negociuar. Tanimë autoritete kontraktuese po përdorin këtë procedurë edhe për tenderë që nuk kanë lidhje me pandeminë. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) si organ që mbikëqyr kontratat e prokurimit publik, duhet që të ndërmarrë veprime ndaj autoriteteve kontraktuese. KRPP duhet gjithashtu që të nxjerrë një vendim ku pandemia nuk cilësohet më si emergjencë ekstreme.

Në pjesën në vazhdim janë analizuar nëntë tenderë që janë lidhur me procedurë të negociuar dhe të hapur në fushën e shëndetësisë dhe të arsimit.

## Ministria e Shëndetësisë - Furnizim emergjent me pajisje dhe material shpenzues medicinal për corona-virus

Në fund të marsit të vitit 2020, në fillim të luftës kundër pandemisë, Ministria e Shëndetësisë publikoi një tender për t'u furnizuar me pajisje dhe material shpenzues medicinal për luftimin e koronavirusit. Kjo kontratë për të cilën ishte parashikuar shuma prej 4,530,406.30 eurosh ishte ndarë në 18 lloje, por përveç tri llojeve, lloji 2 – maska respiratore FFP2, lloji 7 – syze mbrojtëse dhe lloji 16 – mbulesa për shtretër, 15 llojet tjera ishin anuluar. Llojet 1, 3, 4, 5, 6, 11, 12, 13, 14, 15 janë anuluar për shkak të tejkalimit substancial të buxhetit të parashikuar, ndërsa llojet 8, 9, 10, 17, 18 u anuluan në mungesë të ofertave.

Në këtë tender, janë ftuar për të marrë pjesë tetë operatorë ekonomikë, ndërsa kanë ofertuar vetëm katër, ndërkaq tre ishin shpërblyer me kontratë. Tre operatorët që ishin shpërblyer me kontrata për tri llojet, LEGO për llojin 2, Madekos për llojin 7 dhe Komed me lloji 16, nuk kishin pranuar ta ulin çmimin e tyre në ofertën e tyre, me ç'rast janë shpërblyer pastaj vetëm me nga një lloj, ku kanë qenë më të lirë.

Për shkak të rëndësisë dhe çmimit të ofertuar, më tutje do të trajtohet vetëm lloji 2, me të cilën është shpërblyer operatori ekonomik LEGO. Kjo kompani për një maskë FFP2 ka ofertuar 7.95 euro, me ç'rast vlera e kontratës kishte arritur në 1,716,492.00 euro për 215,911 maska. Kjo kontratë kornizë e lidhur në kohëzgjatje prej tre muajsh nuk ishte implementuar në tërësinë e saj. Ministria e Shëndetësisë kishte porositur vetëm 151,140 maska, për të cilat ishin paguar 1,201,563.00 euro, që i bie 70% e kontratës. Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë arsye se pse nuk janë bërë më porosi. Edhe pse sipas ligjit, AK nuk e ka për obligim që të porosisë sasinë e caktuar, është shqetësues fakti që në këtë rast maskast kanë qenë të nevojshme dhe nuk bëhet fjalë për një produkt që nuk ka qenë kërkesë.

Për llojet e anuluar Ministria e Shëndetësisë, ka shpallur ritender, ku vlera e parashikuar ishte rritur dukshëm, për t'ju përafëruar çmimit që ofertuesit kishin dhënë në ofertën e parë, por që ishin anuluar për shkak të tejkalimit të buxhetit.

Kompania Madekos në këtë ritender fitoi tri kontrata për tri lloje, e ku secili lloj ka pasur ofertë identike me vlerën e parashikuar. Ekziton dyshimi se autoriteti kontraktues fare nuk ka bërë llogaritje të vlerës së parashikuar, por ofertën e OE e ka paraqitur si vlerë të parashikuar.

TABELA 3 — Çmimet i njëjtë mes vlerës së parashikuar dhe çmimit të kontratës

Nr. i llojit	Vlera e parashikuar	Çmimi i kontratës
Lloji 4- Veshje mbrojtëse XL	1,084,067.60	1,084,067.60
Lloji 5 - Veshje mbrojtëse XXL	991,677.00	991,677.00
Lloji 18 - Qeska bartjen e mostrës	62,720.00	62,720.00

Ndërkaq, LEGO fitoi llotin 3, po ashtu me veshje mbrojtëse, por me masën L, ndërkaq Komed fitoi llotet 1, 12, 13, 14 dhe 17.

Edhe kësaj radhe dështuan disa lloje, për llotin 6 dhe 11, ofertuesi më i lirë në fazën e negociimit e rriti çmimin në mënyrë drastike. Për llotin 15, ishte tejkualuar buxheti, ndërkaq për llotin 8,9,10 ka pasur mungesë të ofertuesve.<sup>2</sup>

## QKUK - Furnizim emergjent me material medicinal për COVID-19 jashtë LE për ShSKUK

Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) në korrik të vitit 2020 shpalli tender me procedurë emergjente për t'u furnizuar me material medicinal për mbrojtje nga COVID19. Për këtë tender ishin ftuar tetë operatorë ekonomikë, nga të cilët vetëm Madekos dorëzoi ofertë, por autoriteti kontraktues vendosi që këtë aktivitet të prokurimit ta anulojë me këto tri arsye<sup>3</sup>: konkurrenca e vogël, vetëm një operator ekonomik ka dal i përgjegjshëm, procedura e prokurimit ka vlerë shumë të madhe dhe arsyeja e tretë kishte qenë që QKUK-ja ka marrë pajisje mbrojtëse nga BE dhe shteti i Jordanisë.

Pas këtij veprimi, operatori ekonomik ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim, mirëpo e njëjta ishte refuzuar. Madekos, ankesën dërgoi edhe në OShP, e cila e aprovoi në tërësi anuloi vendimin e autoritetit kontraktues, me ç'rast e obligoi të njëjtin që të vazhdojë me nënshkrim të kontratës. Paneli shqyrtues në arsyetimin e vendimit theksoi se ky tender është i natyrës urgjente dhe autoriteti kontraktues duhet të bëjë rivlerësimin e ofertave për shkak të gjendjes së shkaktuar nga pandemia.

Vendimi për anulim i QKUK-së bie ndesh me arsyetimin që kishte dhënë e njëjta për ta përdorur procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë. Në këtë njoftim që ja kishte dërguar KRPP-së, thuhet se për arsye të nevojave të emergjencave ekstreme të pandemisë COVID-19 dhe shtimit enorm të pacientëve të infektuar në nivel vendi është paraqitur nevoja e domosdoshme dhe emergjente për furnizim me produkte mbrojtëse.<sup>4</sup>

Madekos oferto i me çmimin 615,489.00 euro, e ku pastaj në negociatë e kishte ulur për gati 16 mijë euro, në 599,760.00. Andaj, arsyetimi i QKUK për çmim të lartë është i paarsyeshëm, pasi oferta është nën vlerën e parashikuar të tenderit.

Mirëpo është shqetësues fakti që nga tetë ofertues të ftuar për të dorëzuar tender, vetëm një e ka dorëzuar. Për këtë çështje dhe për mundësinë që të ketë pasur ndonjë marrëveshje të fshehtë në mes të operatorëve, duhet Autoriteti i Konkurrencës që të hetojë më tutje.

Autoriteti kontraktues, në gusht, me një porosi të vetme kishte implementuar 100% kontratën, në vlerën që ishte nënshkruar. Mirëpo, meqë ishte kontratë kornizë dhe lejohet devijimi +/- 30%, QKUK kanë bërë edhe porosi tjera në vlerën deri në 175,495 euro, që është brenda +30% të lejuar. Mirëpo duke e ditur që çmimi i produkteve mbrojtëse ishte duke rënë tërë kohën, AK përmes Ministrisë së Shëndetësisë është dashur të kërkojë që të shpallet tender i ri, në mënyrë që të marrë ofertë më të lirë e jo të bëjë porosi shtesë. Ministria e Shëndetësisë (MSH) vetëm

<sup>2</sup> Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, 27.04.2020.

<sup>3</sup> Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, 03.07.2020

<sup>4</sup> Njoftimi për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, 29.06.2020.

më 10 dhjetor 2020 ka shpallur tender tjetër për furnizim me pajisje mbrojtëse, ku janë blerë tri produkte:

- Qese për kufoma me çmim 4.92 euro
- Veshje mbrojtëse e disponueshme me mansheta elastike, Kapuç dhe çizme të bashkangjitura, e bardhë; Madhësitë e veshjeve XL me çmim 7.79 euro
- Veshje mbrojtëse e disponueshme me mansheta elastike, Kapuç dhe çizme të bashkangjitura, e bardhë; Madhësitë e veshjeve XXL me çmim 7.78 euro

TABELA 4 — Krahasimi i çmimeve për veshje mbrojtëse në mes dy kontratave

Produkti	Tenderi 1	Tenderi 2	Sasia	Totali Tenderi 1	Totali Tenderi 2
	MSH 206-20-8232-1-1-5	SHSHKUK 701-20-3273-1-1-5			
	10 dhjetor 2020	23 nëntor 2020			
Veshje mbrojtëse XL	7.78 euro	11.80 euro	3,800	44,840 euro	29,564 euro
Veshje mbrojtëse XXL	7.79 euro	11.80 euro	1,350	15,930 euro	10,516.50 euro

Po të kishte një koordinim më të mirë në mes QKUK dhe MSH, atëherë nuk do të kishte nevojë që të porositen sasi shtesë e veshjeve përmes kontratës së QKUK-së dhe do të bliheshin më lirë përmes së kontratës së MSH. Në këtë rast dallimi në mes çmimeve është (60,770 – 40,080.50) 20,689.50 euro, të cilat janë shpenzuar më tepër pa pasur nevojë. SHSHKUK kur e ka ditur që ka mbetur pa këto produkte është dashur që të zhvillojë procedurë të re të prokurimit ose të kërkojë nga MSH që ta bëjë një gjë të tillë, kur dihet që çmimet e produkteve mbrojtëse vazhdimisht ishin dukë rënë. Këtë e tregon më së miri çmimi i dhënë nga Madekos në kontratën e muajit dhjetor krahasuar me atë të muajit korrik, i cili është 44% më i ulët.

Buxheti i shtetit në mënyrë indirekte ka humbur para edhe në blerjen e maskave. Në kontratën e njëjtë, QKUK ka bërë porosi të reja duke shfrytëzuar mundësinë për të rritur sasinë për 30%. Gjatë muajit nëntor 2020, QKUK ka porositur edhe 12500 maska për të cilat ka paguar 6.25 euro për copë. Mirëpo, QKUK është dashur të shpallë një tender të ri pasi me shumë gjasa do të merrte çmime më të ulëta e jo të vazhdonte bënte porosi përmes kontratës së muajit korrik. Në nëntor 2020 çmimet e maskave kishin rënë dukshëm. Çmimi mesatar për një maskë FFP2 ishte 3 euro. QKUK ka porositur 12500 maska të tjera gjatë kësaj kohë që i kanë kushtuar 78,125.00 euro, ndërsa me çmimin e tregut këto do të kushtonin 37,500 euro, që do të thotë QKUK do të kursente rreth 40,000 euro.

## Komuna e Gjakovës - Marrje në shfrytëzim të pajisjeve me sensorë për dezinfektimin e duarve me dezinfektant

Komuna e Gjakovës në nëntor të vitit 2020 nënshkroi kontratë kornizë në kohëzgjatje prej një viti me grupin e operatorëve Alb Consulting & FRESH – C.O., kontratë kjo përmes së cilës do të vendoseshin në disa objekte komunale pajisje me sensorë për dezinfektimin e duarve. Sipas kësaj kontrate, spërkatësit me sensorë për dezinfektimin e duarve do të vendosen në 46 shkollave të kësaj komune, në konviktin S.Stavileci, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, në Drejtorinë e Arsimit dhe në Administratën Komunale. Përveç në QKMF që do të vendosen 22 pajisje dhe në Administratën Komunale 9 pajisje, në objektet tjera do të do të vendosen nga 1 ose 2 pajisje me sensorë.

Vlera e parashikuar e këtij tenderi ishte 51,324.00€, ndërsa konsorciumi në fjalë ofertuesi i vetëm, me çmim prej 49,140.00 euro.

Vendimi i komunës që pajisjet t'i marrë me qera e jo ti blejë ato nuk ka një kuptim logjik. Gjithmonë kur një gjë blihet kushton më lirë se marrja me qera. Duke marrë parasysh që nuk dihet sa do të zgjasë pandemia dhe dezinfektimi i duarve është i dobishëm edhe pasi të përfundojë pandemia, atëherë komuna do të përfitonë më shumë nëse do t'i blinte këto pajisje.

Sipas përshkrimit teknik, pajisja duhet të ketë kapacitet për 1000ml dhe të jetë mundësia që të mbushet me gell, alkool dhe sapun të lëngshëm. Doza shkarkuese duhet të jetë 0.8-3ml që nënkupton sasia që pajisja spërkat kur të afrohen duart afër saj. Sipas llogaritjes del që me kapacitetin 1000ml të mund të spërkatën në mes 333-1250 dozave. Siç është përmendur më lartë pjesë e kësaj kontratë janë edhe 46 shkolla, të cilat nuk janë të hapura gjatë tërë vitit. Për shembull në muajin janar të vitit 2021 ka qenë rreth një muaj pushim, ndërsa do të ketë rreth tre muaj pushim veror. Kjo do të thotë që komuna do të paguajë për çdo muaj shfrytëzimin e pajisjeve edhe pse ato nuk do të shfrytëzohen nga nxënësit dhe arsimtarët gjatë kësaj periudhe. Po ti blinte komuna këto pajisjes atëherë mbushja me dezinfektues do të bëhej varësisht nga shfrytëzimi i pajisjes. Përmes këtij tenderi komuna do të paguaj për së paku 4 muaj gjatë vitit çmimin prej 45 euro për një pajisje që pothuajse fare nuk do të përdoret.

Edhe pse komuna ka përdorur procedurën e hapur për të lidhur këtë kontratë, vetëm konsorciumi Alb Consulting & FRESH – C.O. aplikoi. Komuna 7 ditë para se të mbyllet afati për dorëzimin e tenderëve shtoi si kriter që OE të jetë i pajisur me certifikatë ISO 22716<sup>5</sup>. Nga uebfaqja zyrtare thuhet se ky standard ka të bëjë me udhëzimet për prodhimin, kontrollin, ruajtjen dhe distribuimin e produkteve kozmetike. Kjo certifikatë aplikohet për praktikën e mira të prodhimit në produkte të kozmetikës. Një dokument i Komisionit European i definon dezinfektuesit e duarve për luftimin e virusit COVID-19 si produkte biokale (anglisht: *biocal*) e jo si produkte kozmetike<sup>6</sup>.

<sup>5</sup> ISO 22716:2017

<https://www.iso.org/standard/36437.html>

<sup>6</sup> Udhëzuesi për aplikimin e legjislacionit për pastruesit e duarve dhe dezinfektuesve të duarve (gel, sol, etj)

<https://ec.europa.eu/docsroom/documents/40523/attachments/2/translations/en/renditions/native>



Gabim procedural i komunës është që nuk ka ofruar kohë shtesë sipas Nenit 25.5 të RRUOPP<sup>7</sup> kur ka publikuar kërkesën për certifikatë ISO 22716. Pasi kërkesa është publikuar 7 ditë para afatit për dorëzim të ofertave, atëherë është dashur që të zgjatet afati për ofertim dhe të OE të kenë së paku 10 ditë afat. Shtimi i kërkesës për ISO 22716 dhe moszgjatja e afatit për ofertim mund të interpretohet që komuna nuk ka dashur që ofertues tjerë të marrin pjesë në tender.

Për këtë tender ka qenë e panevojshme dhe kërkesë jo e natyrës së kontratës që të kërkohet kjo ISO certifikatë e sidomos kur afati për të dorëzuar ofertat ka qenë shumë i shkurtë. Afati i shkurtë ua ka pamundësuar ofertuesve tjerë që të sigurojnë një ISO të tillë nga prodhuesi pasi duke llogaritur vetëm ditët e punës, afati në realitet ka qenë vetëm 5 ditë.

D+ ka bërë edhe hulumtim të tregut, ku për një pajisje të tillë që jepet me përdorim të përkohshëm çmimi është rreth 30 euro për muaj, varësisht nga kontrata, e cila përfshin mirëmbajtjen dhe mbushjen mujore. Pra, për një pajisje që komuna ka marrë në shfrytëzim për 12 muaj (çdo muaj nga 45 euro), komuna ka paguar 540 euro, ndërsa nëse e njëjta do të blihej nga autoriteti kontraktues do të kushtonte rreth 100 euro. Nëse komuna do t'i blinte 91 pajisjet me këtë çmim prej 100 eurosh, të njëjtat do të kushtonin 9,100 euro, ndërsa mbushja e tyre për 12 muaj me dezinfektues gell një litërsh do të kushtonte rreth 6552 euro<sup>8</sup>. Pra blerja e pajisjes, që do të mbeste në pronësi të përhershme të komunës dhe blerja e dezinfektuesit në formë të gelit për 12 muaj, do të kushtonin gjithsej 15,652.00 euro. Komuna pra ka mundur një shërbim të tillë ta sigurojë shumë më lirë, për rreth 35,000 euro më lirë. Komuna është dashur që dezinfektuesit t'i blejë vetë përmes një kontratë dhe pastaj të japë një kontratë kornizë për mbushjen e tyre varësisht sipas nevojës. Me kontratën aktuale komuna do të paguajë për shfrytëzimin e dezinfektuesve edhe kur ato nuk shfrytëzohen, psh. gjatë pushimit veror të shkollave.

## Komuna e Shtimes - Furnizim emergjent me material mbrojtës për COVID-19

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomikë me oferta të ndryshme. Fitues i tenderit u zgjodhe Matkos Pharm Sh.P.K me çmim prej 20,947.20 euro. Dy ofertat tjera kishin çmim më të lartë, ajo e Triomed.Co Sh.P.K me 24,285.00 euro dhe e Trident Sh.P.K me 25,438.00 euro. Ndërkaq, vlera e parashikuar për këtë kontratë ishte 22,112.00 euro. Veprim pozitiv i komunës është se ka ftuar tri kompani për të ofertuar, kur shumica e institucioneve kanë ftuar vetëm nga një, dhe të trijat janë kompani që merren me shitje të produkteve mjekësorë, pra është plotësuar kushti që ftesat duhet të dërgohen të OE të përshtatshëm.

Edhe pse për këtë tender është përdorur procedura e negociuar, në këtë rast nuk ka pasur negociim që të ulet çmimi me asnjërin nga kompanitë. Në këtë mënyrë procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë i humbet esenca e negociimit të kushteve të kontratës.

<sup>7</sup> Neni 25.5. RRUOPP. 2019.

<https://dpl.us/rruopp>

<sup>8</sup> Çmimin me te cilin është llogaritur dezinfektuesi (gell) një litërsh është 6 euro, bazuar në çmimet e tregut.

Nëse merren parasysh disa nga kontratat e lidhura në kohë të njëjtë me këtë kontratë, vërehen disa ndryshime në çmime, të cilat kanë rezultuar si më të lira ngase ka pasur më shumë konkurrencë. Kjo ka ndikuar në çmimet si të maskave ashtu dhe të dezinfektuesve.

Komuna ka paguar për dezinfektues për duar me bazë alkooli 500ml, 4.5 euro. Mirëpo, i njëjti artikull është blerë më lirë nga autoritete tjera kontraktuese në të njëjtën periudhë kohore. P.sh. kontrata e lidhur në mes Ujësllësit Rajonal Prishtina Sh.A dhe Getno LLC, dezinfektuesi 500 ml ka çmim 1.61 euro. Nga ana tjetër një autoritet tjetër kontraktues, Komuna e Skënderajt ka blerë këtë dezinfektues me sasi të njëjtë për 1.29 euro.

E njëjta situatë është me maskat kirurgjike njëpërdorimshme të cilat komuna i ka blerë me çmim 7.70 euro për një pako me 50 maska. Mirëpo në të njëjtin periudhë Komuna e Istogut për të njëjtin produkt ka paguar 4.40 euro për pako. Në këtë periudhë çmimi i pakicës nëpër markete për një pako me 50 maska ka qenë 5-6 euro. Kjo vërtetohet nga çmimet e lidhura në kontratat që janë zhvilluar me procedurë të hapur, ku çmimi mesatar ka qenë rreth 11 cent për një paskë apo 5.5 euro për pako. Prandaj komuna ka dështuar që të sigurohet që çmimi i kontratës nuk është më i lartë se çmimi i tregut, ashtu siç kërkohet në RRUOPP<sup>9</sup>. Nga krahasimi i çmimeve, vetëm për dezinfektuesin, komuna do të kursente së paku 433.50 euro. Ndërsa për maska, buxheti do të kursehej për së paku 1,000 euro.

Komuna edhe pse ka ftuar tre OE për të ofertuar, ka mundur këtë tender ta zhvillojë përmes procedurës së hapur dhe do të mund të merrte oferta më të lira. Komuna ka dështuar që të sigurohet që çmimi i kontratës nuk është më i lartë se çmimi i tregut, i cili është një parimet themelore të prokurimit publik.

## **Komuna e Podujevës – Furnizim me mjete higjienike parandaluese dhe mbrojtëse kundër COVID-19 për nevoja të shkollave**

Në të njëjtën periudhë kohore sikurse Komuna e Shtimes edhe Komuna e Podujevës në gjysmën e dytë të viti 2020 kishte iniciuar aktivitet prokurimi me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Vlera e parashikuar për këtë tender ka qenë 48,000.00 euro ndërsa kompania fituese është shpallur KIGA Sh.P.K në vlerë prej 47,105.60 euro.

Për të marrë pjesë në këtë procedurë janë ftuar tre operatorë ekonomikë, MadeKos, Neramed dhe fituesi, operatori ekonomik KIGA. Nga këta tre operatorë, kanë ofertuar vetëm Neramed dhe Kiga. Veprim pozitiv dhe në përputhje me ligjin është se komuna i ka ftuar tri kompani që janë të përshtatshme për këtë aktivitet të prokurimit, pra të trijat janë kompani që merren me tregti të produkteve mjekësore.

Megjithatë, edhe pse ka qenë procedurë e negociuar edhe ky proces ka kaluar pa u mbajtur negociatat dhe duke mos u dhënë mundësia që të diskutohen kushtet e kontratës mes tjerash dhe më e rëndësishmja, negociimi për ulje të çmimit.

---

<sup>9</sup> Neni 52.7 (ii). RRUOPP. 2019.  
<https://dpl.us/rruopp>

Arsyeja pse nuk janë mbajtur negociatat me operatorët ekonomikë, sipas autoritetit kontraktues, ka qenë gjendja emergjente me pandeminë dhe rihapja e shkollave, të cilat kërkonin të pajiseshin me material dezinfektues. Afati për dorëzimin e ofertave për këtë tender ka qenë data 21.09.2020, ndërsa përfundimi i procedurës për blerjen e artikujve të kërkuar është bërë më 06.10.2020, megjithatë, Ministria e Arsimit më 11.09.2020 ka lëshuar vendim për fillim të vitit shkollor që do të organizohej në dy faza. Ndërsa komuna vetëm më 18.09.2020 i ka dërguar ftesat për ofertim për operatorët ekonomik. Po të fillonte procedura më herët atëherë do të mund të mbaheshin edhe negociatat.

Gjatë implementimit të kontratës komuna nuk ka respektuar hapat që kërkohen në bazë të Rregullës Financiare 01/2013. Komuna ka pranuar mallin dhe pastaj ka dërguar porositë te operatori ekonomik, ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta, së pari të bëhet porosia përmes urdhërblërjeve e pastaj të pranohet mallit. Sipas Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 22 thotë që së pari duhet të bëhet kërkesa për blerje, pastaj urdhërblerja, hapi i tretë është raporti i pranimit e në hapin e katërt është pranimi i faturës. Pas pranimit të faturës mund të bëhet pagesa<sup>10</sup>. Komuna ka pranuar furnizimin më 6 tetor 2020, ndërsa ka dërguar urdhërblerjen më 14 tetor 2020. Në dosje të tenderit është kërkuar që OE të dërgojë furnizimin pesë ditë pas pranimit të urdhërblërjes. Komuna nuk ka mundësi në këtë mënyrë që të masë afatin e furnizimit pasi furnizimi është bërë para dërgimit të urdhërblërjes.

Meqenëse procedura ka qenë e negociuar, operatorët ekonomikë kanë ofertuar me çmime më të larta, e cila është pasojë e konkurrencës së dobët. E kjo gjë do të evitohet sikur autoriteti kontraktues ta zhvillonte këtë tender me procedurë të hapur. Konkurrenca më e madhe shton gjasat që kontrata të jetë me çmime më të ulëta. Krahasuar me kontratën e lidhur nga Komuna e Shtimes, që ka paguar 7.70 euro për një kuti me maska, Komuna e Podujevës ka blerë të njëjtën pako në vlerë prej 9 euro. Sikur komuna ta përdorte procedurën e hapur do ta lidhte kontratën me çmime më të ulëta. Prandaj është e paarsyeshme që mos të përdoret procedura e hapur, e sidomos kur mund edhe përmes kësaj procedurë të shkurtohet afati për të ofertuar.

## **Policia e Kosovës - Furnizim me material mbrojtës maska dhe dezinfektues**

Ndryshe nga shumë institucione, Policia e Kosovës përdori procedurën e hapur për tenderin për furnizim me maska dhe dezinfektues. Tenderi u nda në dy lloje, ku për pjesën e parë ishin destinuar 60,000.00 euro, pra për furnizim me dezinfektues, ndërsa për pjesën e dytë, për maska, 64,960.00 euro, e në total vlera e parashikuar e gjithë tenderit ishte 124,960.00 euro. Për pjesën e parë, me kontratë është shpërblyer operatori ekonomik Bodrumi i Vjetër, oferta e të cilit ishte 31,500.00 euro, ndërsa për llotin e dytë, me kontratë është shpërblyer kompania NORD me vlerë të kontratës prej 34,776.00 euro. Me këta operatorë është lidhur kontratë kornizë, e paraparë të zgjasë 12 muaj. Lidhja e kontratave kornizë ka të mirat e saja, sidomos në këtë kohë pandemie, pasi sipas nevojave të autoritetit, mund t'i bëjë porositë te operatorët

---

<sup>10</sup> Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10203>

që kanë fituar llotet përkatëse në këtë rast. Megjithatë përdorimi i kontratës kornizë në kohën kur çmimi i këtyre dy produkteve është duke rënë vazhdimisht nuk është shumë e arsyeshme.

Përdorimi i procedurës së hapur i ka garantuar Policisë së Kosovës që do të ketë numër të madh të ofertave. Pikërisht, për llot 1 kanë ofertuar 25 OE, ndërsa për llot 2, 16 OE. Kjo tregon që kur përdoret procedura e hapur ka konkurrencë dhe shtohen gjasat që kontrata të lidhet me çmime më të ulëta.

Megjithatë, për llot 1, çmim më të ulët ofertuan disa operatorë tjerë ekonomikë. Ndër ta ishin Happy Sh.P.K me 22,700.00 euro, Beni Dona po ashtu me 22,700.00 euro, Vlora & Office 1 Kosova me 29,900.00 euro dhe Day Star me 30,000.00 euro. Arsye e eliminimit të tyre kryesisht kishte të bënte me mostrën e produkteve e cila u kërkuar në dosje të tenderit. Day Star edhe është eliminuar pasi nuk ka sjellë mostrën në ditën e hapjes së ofertave. AK kishte kërkuar që dezinfektuesi prej 500ml të jetë i pajisur me bombolën me vrimë nxjerrëse, të cilën shihet se OE Day Star e plotëson sipas katalogut të dorëzuar. Mirëpo mostra e dërguar nga Bodrumi i Vjetër nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit pasi nuk dezinfektuesi 500ml nuk ka bombolë me vrimë nxjerrëse, por ka vetëm kapakun që mundëson daljen e lëngut për dezinfektim. Sigurisht që pajisjet që kanë bombolë nxjerrëse mund të kenë kosto më të lartë të prodhimit. Mosplotësimi i kërkesës i ka mundësuar OE që të ofertojë me çmim më të lirë.



Figura 1: Mostra që ka dërguar Bodrumi i Vjetër

Një kërkesë e panevojshme ishte bërë për llot 2, furnizimi me maska, ku PK ka kërkuar që OE të ketë certifikatë ISO 9001. Kjo certifikatë ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë. Megjithatë sipas kërkesës nuk specifikohet se a duhet certifikata të jetë e prodhuesit apo e ofertuesit. Sidoqoftë pasi pjesa më e madhe e maskave në treg janë të importuara dhe nuk janë të prodhuara nga ofertuesit e këtij tenderi, kërkesa ka qenë e panevojshme e cila ka bërë që disa ofertues të eliminohen për mosplotësim të kësaj kërkesë.

Ofertë më të lirë për pjesën e dytë të këtij tenderi e ka dhënë OE Europrint Group në vlerë prej 16,380.00 euro. Kjo kompani është eliminuar nga gara pasi mostra nuk i plotësonte kërkesat e dosjes së tenderit.

Çmimi për maska të thjeshta i kontraktuar nga PK është 0.12 euro për një maskë. Ky tender është iniciuar gjatë muajit gusht 2020. Për dallim, Komuna e Shtimes dhe Podujevës në tenderët e iniciuar në shtator 2020 kanë paguar më shtrenjtë për maska, vetëm sepse kanë përdorur procedurën e negociuar. Vendimi i PK që të përdorë procedurën e hapur është shpërblyer me konkurrencë të madhe dhe me çmime më të lira.

Mirëpo edhe ky tender ka mundur të zhvillohet me procedurë tjetër për të arritur ekonomikitetin në prokurim publik. Në fillim të pandemisë çmimi i maskave ka qenë i lartë, ndërsa me normalizimin e gjendjes çmimet kanë rënë dukshëm. Kuptohet se çmimet vazhdojnë e bien, veçanërisht për maska e dezinfektues, e në këtë rast meqenëse Policia e Kosovës ka lidhur kontratë publike kornizë, ajo duhet të vazhdojë aktivitetin e saj me ato çmime me të cilat është lidhur kontrata. Ndërsa tani në tregun me pakicë një maskë mund të blihet për 10 cent, ndërsa me shumicë ky çmim mund të jetë edhe më i ulët. Prandaj PK është dashur ta përdorë procedurën e hapur të zakonshme duke pasë parasysh që në rast nevojë mund të shpallte prapë tender të ri. Prandaj, lidhja e kontratës kornizë për artikuj që vazhdimisht ju bjen çmimi në treg, nuk mund të konsiderohet si ide e mirë.

## Komuna e Prizrenit - Furnizim me tableta për shkollat e Komunës së Prizrenit

Në dhjetor të vitit 2020, Komuna e Prizrenit, për shkak të gjendjes me pandeminë, ku në disa raste shkollat ishin mbyllur dhe mësimi ishte zhvilluar online, vendosi të blejë 500 tableta dhe një laptop. Fillimisht komuna anuloi në po këtë muaj tenderin paraprak për shkak që dy ofertuesit nuk kishin ofruar tabletët sipas specifikave teknike. Për tenderin aktual komuna ka ndryshuar afatin për t'i dorëzuar ofertat, duke e shkurtuar nga 20 në 10 ditë.

Vlera e parashikuar e tenderit ishte 67,000.00 euro, për të cilin kishin ofertuar tre operatorë ekonomikë, ndërsa fitues u zgjodh kompania FutureBits, me çmim 62,582.76 euro.

TABELA 5 — Ofertuesit në tenderin Furnizim me tableta për shkollat e Komunës së Prizrenit

Nr.	Operatori ekonomik	Çmimi
1	FutureBits SHPK	62,582.76
2	Europrinty	65,330.00
3	InterAdria	65,749.00

Europrinty ishte eliminuar nga tenderi për shkak që nuk kishte dorëzuar katalog të produkteve, ndërsa InterAdria nuk kishte fituar për shkak të çmimit më të lartë.

Specikacioni teknik për tabletë që kishte përgatitur komuna ishte deri diku i detajuar. Në disa pjesë është lejuar mundësia që të ofrohen minimumi dhe maksimumi, si p.sh. RAM memorie është lejuar të ofrohet 2-4 GB. FutureBits ka ofruar tabletin KEP K-S18 të prodhuesi KEP Technology nga Kina. Mirëpo, ky tablet nuk përkrah specifikat teknike të kërkuara. Në tabelën më poshtë janë paraqitur specifikat e kërkuar dhe ato që ofrohen nga ky tablet:

TABELA 6 — Specifikat teknike të tabletit të ofertuar me ato të kërkuara

Specifikat e kërkuar	KEP K-S18
<b>Procesori: Octa Core 1.8 Ghz, 1.6 Ghz</b>	UNISOC SC9863A me performancë <b>1.6 Ghz</b> maksimum <sup>11</sup>
<b>Bateria: 6150mAh e integruar, ose më e mirë</b>	Bateria është <b>6,000mAh</b> <sup>12</sup>
<b>WiFi 802.11 a/b/g/n/ac</b>	WiFi 802.11 b/g/n <sup>13</sup>
<b>Slot për MicroSD Card: Up to 256GB për storage shtesë</b>	Vetëm deri <b>128GB</b> shtesë <sup>14</sup>

Në katër specifika teknike, oferta e FutureBits ka karakteristika më të dobëta të cilat ndikojnë që çmimi i tabletit të ofruar të jetë më i lirë se i kompanive tjera. FutureBits për një tablet ka dhënë çmimin 123.23 euro, Europrinty 129 euro, ndërsa InterAdria 130 euro. Megjithatë as InterAdria nuk do t'i plotësonte këto specifika pasi tableti i saj ka të njëjtin procesor, ndërsa Europrinty nuk ka dorëzuar katalog në mënyrë që të mund të krahasohet. Futurebits në katalogun që siç duket është krijuar nga vetë kompania ka shënuar që tableti ka bateri 8000mAh, mirëpo faqja zyrtare thotë që kapaciteti është 6,000mAh. Njëjtë është edhe me versionin e WiFi, për të cilin FutureBits ka shënuar që tableti përkrah versionet WiFi a/b/g/n/ac, mirëpo faqja zyrtare e prodhuesit të tabletit ka cekur që përkrahen vetëm versionet WiFi b/g/n. Kjo mbështetet edhe nga të dhënat që gjenden në prodhuesin e procesorit, i cili e thotë të njëjtën gjë. Versionet më të avancuara të WiFi kushtojnë më shumë për prodhuesit, pasi ofrojnë shpejtësi më të mëdha gjatë transferimit të të dhënave.

Procesori është kërkuar që të jetë me tetë bërthama, të ndara në dy pjesë prej katër bërthamash, njëri me shpejtësi 1.8 Ghz dhe tjetri me shpejtësi 1.6 Ghz. Mirëpo të dhënat për procesorin SC9863A që gjendet në tabletin e ofruar nga FutureBits tregojnë që shpejtësia maksimale është 1.6Ghz, përkatësisht 1.2 Ghz. Në fund, hapësira për memorie shtesë është ofruar përgjysmë të asaj që është kërkuar, nga 256GB në 128GB. Kur merret parasysh që hapësira e brendshme është vetëm 32GB, e një pjesë të madhe të saj e merr sistemi operativ, atëherë ka qenë më së e nevojshme që tableti të përkrahë memorie me kapacitet më të madh.

Siç duket komisioni i vlerësimit nuk ka bërë punën siç duhet, pasi përveç FutureBits, as InterAdria nuk plotëson specifikat teknike.

Edhe pse komuna ka shkurtuar afatin për dorëzim të ofertave, vlerësimi i ofertave ka zgjatur shumë. Ofertat janë dorëzuar më 28 dhjetor 2020, ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është publikuar më 19 shkurt 2021. Vlerësimi sipas LPP duhet të zgjasë jo më shumë se 30 ditë e në raste të caktuara mund të zgjasë edhe për 20 ditë shtesë. Kur merret parasysh që nevoja për tablete ka qenë e menjëhershme, sepse në janar të vitit 2021 veç kishte filluar gjysmëvjetori i dytë i vitit shkollor, i bie që komuna është vonuar shumë në vlerësim të ofertave.

<sup>11</sup> UNISOC SC9863A

<https://dpl.us/n4n>

<sup>12</sup> KEP K-S18

<http://www.kep-tech.com/h-pd-78.html>

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.

Kontrata me FutureBits është nënshkruar më 1 mars 2021, me afat për dorëzim të pajisjeve jo më shumë se 30 ditë pas kësaj date. Mirëpo, deri më 5 maj 2021 tabletët ende nuk janë dorëzuar, ndërsa sipas komunës ato pritet të dorëzohen në mes datave 10-15 maj. Gjatë prillit, Kosova pati një mbyllje tjetër 12 ditore shkaku i pandemisë gjatë së cilës kohë mësimi është zhvilluar online. Sipas kontratës, në këtë periudhë nxënësit do të duhej t'i kishin tabletët. Koha e paraparë kur tabletët do të vijnë është shumë afër përfundimit të vitit shkollor, me çka edhe humbet efekti i tyre për këtë vit shkollor. Përdorimi i tyre për vitin e ardhshëm shkollor varet nga situata me pandeminë.

Megjithatë, komuna e ka një mekanizëm që mund ta shfrytëzojë për ta ndëshkuar FutureBits për këtë vonesë. Sipas nenit 16 të kushteve të përgjithshme të kontratës, komuna mundet që t'ia ndalojë 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të padorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës. Pasi që tabletët është dashur të dorëzohen deri më 31 mars 2021, deri në datën 10 maj, si datën më të afërt për dorëzim, do të kenë kaluar 40 ditë. Pasi  $40 * 0.25 = 10\%$ , atëherë komuna duhet t'ia paguajë faturën 10% më pak, që është 6,161.40 euro.

Komuna e Prizrenit përveç që i ka dhënë kontratën OE që nuk ka plotësuar specifikat teknike, nuk ka ndonjë dokument që tregon që kompania është gjobitur për vonesën në dërgimin e tabletëve në shkolla. Kjo e ka humbur në masë të madhe efektin e tabletëve në procesin mësimor.

## Komuna e Skënderajt - Furnizim me projektor për shkolla dhe tabletë për nxënës

Komuna e Skënderajt në dhjetor të vitit 2020 publikoi tenderin për furnizim me projektor dhe tabletë, me vlerë të parashikuar prej 9,900 euro. Në këtë tender morën pjesë gjashtë ofertues, ku fitues është zgjedhur kompania Eor Group me çmim 8,213.34 euro, e cila njëkohësisht kishte edhe çmimin më të ulët.

TABELA 7 — Ofertuesit në tenderin Furnizim me projektor për shkolla dhe tabletë për nxënës

Nr.	Operatori ekonomik	
1	Eor Group SHPK	8,213.34
2	Trio Tek SHPK	9,836.50
3	Aritech	10,541.93
4	AWA SHPK	8,632.88
5	Infinitt SHPK	8,946.76
6	Pro Max SHPK	8,780.00
		8,213.34

Për dallim nga Komuna e Prizrenit, specifikat teknike për tabletë janë më të thjeshtëzuar. Komuna nuk ka përcaktuar lloj të procesorit, model të WiFi, etj. Mirëpo për projektor, specifikat teknike janë shumë të detajuara dhe vërehen që janë kopjuar direkt nga përshkrimet teknike të ndonjë produkti.

Eor Group ka ofertuar më tabletin nga prodhuesi Vivax, modeli TPC-102 4G dhe specifikat teknike të kërkuara përputhen me këtë model.

Për projektor Eor Group ka ofertuar me modelin Ricoh PJ S2440, model i cili nuk i plotëson specifikat teknike të kërkuara.

**TABELA 8** — Specifikat teknike të tabletit të ofertuar me ato të kërkuara

Specifikat e kërkuara	Specifikat e Ricoh PJ S2440
Jetëgjatësia ekonomike e llampës, 7000 orë	Jetëgjatësia ekonomike e llampës, <b>6000</b> orë <sup>15</sup>
Jetëgjatësia ekonomike e llampës, 6000 orë	Jetëgjatësia ekonomike e llampës, <b>5000</b> orë <sup>16</sup>
Distanca minimale e projektimit – 1m	<b>Distanca minimale e projektimit – 1.18m</b> <sup>17</sup>

Nga tabela më lartë vërehet se një nga elementet më kryesorë të një projektori, që është jetëgjatësia e llampës, nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit. Si rezultat për këtë arsye oferta e Eor Group do të duhej të shpallej e papërgjegjshme. Sikurse në tenderin e Komunës së Prizrenit edhe në këtë tender komisioni i vlerësimit nuk e ka vlerësuar ofertën sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

<sup>15</sup> Ricoh PJ S2440

[PJ S2440 Entry Level Projector i Ricoh USA \(ricoh-usa.com\)](https://www.ricoh-usa.com/products/projectors/pj-s2440)

<sup>16</sup> Po aty

<sup>17</sup> Po aty.



# Rekomandime:

- Autoritetet kontraktuese të ndalojnë së përdoruri procedurën e negociuar për ato kontrata të cilat mund të zhvillohen me procedurë të hapur;
- Autoritete kontraktuese, në rast të përdorimit të procedurës së negociuar të ftojnë kompani të përshtatshme për të ofertuar;
- KRPP të vlerësojë se a është situata emergjente apo jo dhe të aprovojë përdorimin e procedurës së negociuar rast pas rasti.
- Në rast të përdorimit të procedurave emergjente, zhvillimi i negociatave të bëhet një hap i detyrueshëm para se të nënshkruhet kontrata;
- Të bëhet studim dhe planifikim i detajuar para fillimit të një aktiviteti të prokurimit, për t'i shmangur kështu problemet siç janë: vlera shumë e lartë e parashikuar (ose më e ulët se vlera e punëve), me ç'rast mund të vije deri të rritja e çmimit të ofertave në rastin e parë ose në rastin e dytë deri te anulimi dhe shtyrja e një aktiviteti të prokurimit;
- Autoritetet kontraktuese të sigurohen që vlerësimi i tenderëve bëhet në bazë të specifikave teknike
- Evitimin e kërkesave të panevojshme për operatorët ekonomikë, siç është rasti me kërkesën për ndonjë certifikatë që përveç që nuk lidhet me aktivitetin e prokurimit në fjalë, ajo vënë në pozitë të pafavorshme operatorët tjerë;
- Të merren masa ndaj operatorëve ekonomikë që nuk e përmbushin kontratën me kohë. Mos përmbushja e kontratave në kohë të caktuar, sidomos të atyre që janë nënshkruar edhe përmes procedurave të negociuar për shkak të emergjencave mund të dëmtohet interesi publik.







Demokrasi Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jo fitimprurëse e themeluar nga një grup aktivistësh që besojnë fuqishëm në vlera demokratike dhe në një Kosovë me demokraci të mirëfilltë. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike, si dhe politika që ndërtojnë një shoqëri aktive.